

Nr 121 prot

30.06.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPERMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Nr. 4198/Prot.

Tiranë, më 25.6.2014

Drejtuar: **SH.A " AEROPORTI NËNË TEREZA "**

TIRANË

Lënda : Miratohet statuti i shoqërisë " Aeroporti Nënë Tereza " Tiranë.

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria " Aeroporti Nënë Tereza " Tiranë, me shpresën Nr. 102, datë 28.5.2014, konstatojmë se ai është hartuar në zbatim të dispozitave të nenit 230 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Për këto arsye bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8158, datë 07.11.1996, ndryshuar me dekretin Nr. 3318, datë 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, nenit 216 e në vijim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", aksionari shtet i cili zotëron 100% të aksioneve të Sh.a " Aeroporti " Nënë Tereza" Tiranë, miraton statutin e ri të shoqërisë.

Ngarkohet Sh.a " Aeroporti Nënë Tereza " Tiranë, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, Regjistrimi fillestar, neni 32.36.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
AEROPORTI "NËNË TEREZA" SHA



**STATUT
I
SHOQËRISË ANONIME**

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është statuti i shoqërisë;
- "aksionarë" janë personat emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si zotërues të aksioneve;
- Ky statut është hartuar ne baze te "Modelit te Statutit per Shoqerite tregtare me dy nivele" modeluar nga QKR.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e faqes së internetit
Neni 1

Themelimi, Emërtimi

Shoqëria anonime u krijua nga transformimi i Ndërmarrjes shtetërore "Albtransport" Tiranë (krijuar më 21/01/1957) me Vendim të Gjykatës shkallës së parë të rrethit Tiranë, dt 18 Janar 1999. Me Vendim Nr. 20819/7, dt 20.03.2003 të Gjykatës Tiranë Shoqëria emërtohet:

{Aeroporti "Nënë Tereza" sh.a} Tiranë.

Neni 2

Objekti i shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Dhënja me qera e aseteve që zotëron shoqëria.

Zbatimi i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr.9312 datë 11.11.2004 I marrëveshjes së Koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" Rinas.

Shoqëria siguron mjetet e veta monetare nëpërmjet aktivitetit të saj ekonomik të qeradhënjes së aseteve që zotëron.

Të ardhurat gjithësej të shoqërisë përbëhen:

- a) Të ardhurat e qerasë së aktiveve të cilat u janë dhënë në përdorim subjekteve vendase apo të huaja.
- b) Interesat e mjeteve financiare të depozituara në bankë.

Shoqëria brenda neneve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 3

Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike.

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Durrësit Nr.202 Tiranë
- (2) Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është: s 'ka
- (3) Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :
<abtransportSha@gmail.com>

Kreu II

Kapitali i Regjistruar, Aksionet

Neni 4

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 3.714.037.296,00 Lekë ne baze te miratimit me vendimit nr 197, datë 13.03.2008" te Ministrise se Ekonomise.

Numri i aksioneve është 3.714.037. Vlera e aksionit është 1000 Lekë. Aksioner i vetem Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Aksionet do të mbahen në "Regjistrin e Aksioneve" nga personi përgjegjës i caktuar nga Këshilli Mbikqyrës në përputhje me nenin 119 të Ligjit .

Neni 5

Zmadhimi ose zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Asambleja e Përgjithshme në pajtim me Ligjin mund të zmadhojë ose të zvogëlojë Kapitalin Themeltar të shoqërisë me shumicën e kualifikuar të votave të përfaqësuesve të saj.

Kreu III Asambleja e Përgjithshme

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e Keshillit Mbikqyres;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.Të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme të parashikuara nga Ligji që nuk janë shprehur në këtë statut, ushtrohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me cilësinë e aksionerit të vetëm.

Neni 7

Emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar

- (1) Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë për tre vjet me radhë, në pajtim me shkronjën "ç", pika 2 e nenit 135 të Ligjit. Emërimi behet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë.
- (2) Gjatë mandatit të tyre, ekspertët kontabël të autorizuar mund të largohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme. Mendimet e ndryshme për metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme për largimin ekspertëve kontabël të autorizuar.

(3) Eksperti Kontabël i Autorizuar ose shoqëria e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i raporton Asamblese se Përgjithshme në përputhje me pikën 3 të nenit 6 të këtij Statuti, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe, në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

Kreu IV

Neni 8

Administratorët Emërimi i Administratorëve

(1) Këshilli Mbikëqyrës zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë në pajtim me pikën 2 të nenit 135, pikën 2 të nenit 167 dhe nenin 158 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit Mbikëqyrës sipas nenit 13 të Statutit, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator të Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorët nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

(2) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si Administratorë. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 158 të Ligjit.

Neni 9

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme
- 2) Këshilli Mbikëqyrës
- 3) Administratori ose Drejtoria

Neni 10

Këshilli Mbikëqyrës

- Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bazë të akteve Ligjore dhe nënligjore.

- Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

- Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar me zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

- Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të moshës mbi 65 vjeç nuk mund të jenë më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të këshillit mbikëqyrës. Nëse ky raport tejkalohet anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

- Këshilli Mbikëqyrës nuk merr pjesë në administrimin e Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët dhe kontrollon pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit dhe të Statutit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" e "i" të pikës 1 dhe pika 2 e nenit 154 të Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratorëve.

- Në veçanti, Këshilli Mbikëqyrës:

1. Mbikëqyr procesin e raportimit financiar.
2. Mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve.
3. Mbikëqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara, sipas Statutit.

4. Shqyrton dhe mbikëqyr pavarësinë e ekspertëve kontabël të autorizuar ose të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar dhe, në veçanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.
- Asnjë ndryshim i Statutit dhe udhëzim i Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Këshillit Mbikëqyrës të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishte dhënë udhëzimi.

Neni 11

Kryetari dhe zv/kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës zgjedh nëpërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zv/kryetar, të cilët thehresin mbledhjen e këshillin dhe të drejtojnë diskutimet. Ata zgjidhen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli mbikëqyrës mund të ngarkojë një person si sekretar dhe jashtë anëtarëve të tij. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e këshillit mbikëqyrës drejtohen nga zv/kryetari.

Neni 12

Skualifikimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

(1) Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

1. personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 13

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës mbledhet në baze të Planit Vjetor të aktivitetit dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesë të tij të zv/kryetarit dhe administratorit. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kur Administratori/Drejtorja ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës i paraqitin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët duhet të thërrasin mbledhjen e këshillit mbikëqyrës, duke i përcaktuar rendin e ditës. Në parim thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara, me letër, telegram, telex ose faks. Por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe me gojë. Çdo thirrje duhet të përcaktojë rendin e ditës.

Mbledhja e këshillit mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër të përcaktuar në thirrje. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, në rast barazimi votash ajo e kryetarit është përcaktuese.

Këshilli mbikqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e këshillit mbikqyrës evidentohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga kryetari ose zv/kryetari.

Kopjet e vendimeve vërtetohen nga kryetari ose zv/kryetari i këshillit mbikqyrës.

Neni 14

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

- Këshilli mbikqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga Administratori/Drejtorja dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga Drejtorja pa autorizimin e këshillit mbikqyrës.

- Këshilli mbikqyrës emëron Administratorin/Drejtorin.

- Me emërimin e Administratorit/Drejtorit, Këshilli Mbikqyrës lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

- Këshilli Mbikqyrës autorizon Drejtorinë që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenin 10 të këtij statuti.

- Këshilli mbikqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që i gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

- Drejtorja i paraqet raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, drejtorja duhet t'i paraqesë këshillit mbikqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

- Këshilli Mbikqyrës i propozon Ministrin të Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes (Asamblesë së Përgjithshme) lidhur me këto çështje:

a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të Shoqërisë.

b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë.

c) Hapja e veprimtarive ose njësisive të reja dhe ndryshimin e objektit të Shoqërisë.

d) Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të Shoqërisë.

e) Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.

f) Marrjen e huave afatmesme dhe afatgjata.

g) Si dhe çdo gjë tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 15

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikqyrës do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Administratori - Drejtorja

- Shoqëria administrohet nga Administratori/Drejtorja e cila mund të përbëhet nga një ose disa anëtarë. Numri i anëtarëve të drejtorisë caktohet nga Këshilli mbikqyrës me një vendim të tij.

- Administratori/Drejtorja emërohet nga Këshilli Mbikqyrës kur për të janë dakort jo më pak se 2/3 (dy të tretat) e të gjithë anëtarëve të këtij këshilli.

- Administratori është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai mund të zgjidhet dhe jashtë të punësuarve në Shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikqyrës emërohet anëtar i drejtorisë mandati i tij në këshillin mbikqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet anëtar

drejtorie ose drejtor në më shumë se një shoqëri. Administratori mund të shkarkohet nga Këshilli mbikqyrës për shkaqe të përligjura. Në rastin kur i interesuari ka lidhur kontratë punësimi me shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i Administratorit nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës.

- Në rastet e pushimeve dhe mungesave të zgjata nga Administratori, Këshilli mbikqyrës bën zëvendësimin e tyre.

- Administratori është i riemërueshëm, Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç. Administratori që mbush moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Paga e Administratorit caktohet nga këshilli mbikqyrës në përputhje me V.K.M në fuqi.

Neni 17

Kompetencat e Administratorit/Drejtorit

- Administratori ka kompetence të plote për të vepruar në emër të shoqërisë.

- Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrime që rrejdhin nga aktet e Administratorit/Drejtorisë të nënshkuara nga anëtari me cilësinë e drejtorit edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Drejtorisë kapërcente objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

- Aktet në të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve duhet të nëshkruhen nga anëtari me cilësinë e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

- Drejtoria merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm kur janë prezent jo më pak se gjysma e anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash, vota e anëtarit të caktuar me cilësinë e Drejtorit është përcaktuese.

- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 vjet dhe me vlerë mbi 2 milion lekë bëhet me autorizim të këshillit mbikqyrës.

- Drejtoria bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton këshilli mbikqyrës.

- Drejtoria harton rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe e miraton në Këshillin Mbikqyrës.

Neni 18

Marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe Drejtorisë ose të një anëtari të Këshillit Mbikqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe anëtarëve të drejtorisë ose një anëtari të këshillit mbikqyrës qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të Këshillit Mbikqyrës.

Përcaktimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe një Shoqërie tjetër, kur një anëtar i këshillit mbikqyrës është dhe anëtar i këshillit mbikqyrës të një Shoqërie tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshja. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të Shoqërisë që kryhen në kushte normale.

Anëtari i drejtorisë ose i këshillit mbikqyrës i interesuar duhet të njoftojë këshillin mbikqyrës për një marrëveshje për të cilën zbatohet kërkesa e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i këshillit mbikqyrës nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

Neni 19

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspert kontabël i autorizuar, i cili emërohet nga Asmableja e Përgjithshme dhe që kryen misionin e tij në pajtim me ligjin.

Neni 20

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë lëtimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Neni 21

Marrëdhëniet e punës

Për marrëdhëniet e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit do të zbatohen kriteret e përcaktuara në kontratën individuale të punës e cila do bazohet në Kodin e Punës.

Neni 22

Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë.

Neni 23

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Miratohet

Përfaqësuesi i Asamblesë së Përgjithshme

Arben AHMETAJ

MINISTËR

dt. 25.06.2014